

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27.10.2006

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 27.10.2006.god.

TETOR - OKTOBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Koha për pyetjet e deputetëve,
3. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditimit Gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës (shpërndarë deputetëve më 6 tetor 2006),
4. Shqyrtimi i raportit për punën e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2005 (materiali bazë është shpërndarë më 12 shtator, ndërsa materiali plotësues më 24 tetor 2006).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање дневног реда,
2. Време за посланичка питања,
3. Разматрање Извештаја Канцеларије Генералног Ревизора о чињеничном стању у Скупштини Косова (достављен посланицима 6.октобра 2006.год.),
4. Разматрање Извештаја о раду Регулативног Ауторитета за Телекомуникацију за 2005. годину (основни материјал је достављен 12. септембра 2006. године, док допунски материјал 24.октобра 2006. године).

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10,00

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Të nderuar kolegë deputetë të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Andaj propozoj ta fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Materiali për pikën e tretë të rendit të ditës ka ngatërrim. Më 6 tetor 2006 në shkresën 022628 për deputetë të Kuvendit të Kosovës të dërguar nga Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit, në rubrikën subjekti shkruan: Raport i auditimit të jashtëm, ndërsa në letrën që juve personalisht ua ka dërguar Zyra e Auditorit Gjeneral, të cilën ju e keni marrë më 3 korrik të vitit 2006, që lidhur me këtë çështje, ndër të tjera qëndron se intervista formale në menaxhmentin e Kuvendit nuk ka pasur dhe se këto të dhëna janë burimore të një burimi të dhe të paverifikuara.

Në letër Zyra e Auditorit Gjeneral vazhdon: Saktësia dhe plotësia e këtyre informatave dhe e dokumentacionit është marrë dhe nuk është testuar në ndonjë mënyrë, procedurat që ne i kemi kryer, thotë Zyra e Auditorit Gjeneral, nuk përmbajnë auditim dhe si të tilla nuk përmbajnë as opinionin e auditimit dhe në asnjë fushë Në paragrafin e fundit të letrës që ju e keni marrë më 3 korrik Zyra e auditorit gjeneral, z. kryetar, përfundon. Juve ju shkruan se ne jemi në proces të finalizimit të auditimit tonë me pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2005 dhe është pritur të japin opinion të kualifikuar të auditimit dhe mundësi që ne mund të heqim dorë nga dhënia e opinionit. Në bazë të shkresës së zyrës së auditorit gjeneral, z. kryetar, ky nuk është auditim. Këtë material më 4 tetor 2006 e ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës që ndër të tjera përfundon: Meqenëse procedurat që janë kryer nuk përmbajnë auditim dhe si të tilla nuk e përmbajnë opinionin e auditimit, ne presim që zyra e revizionit gjeneral ta finalizoj procesin e auditimit me pasqyrë financiare të Kuvendit për vitin 2006, ku do të kemi edhe opinionet e kualifikuara. Andaj, z. kryetar, duke mbështetur transparencën e plotë financiare në institucionet e Kosovës e në veçanti në Kuvendin e Kosovës, kërkojmë të leni kohë që të përfundojë auditimi dhe ai material i auditimit të plotë të jashtëm të vijë në Komisionin për Buxhet dhe t'i shohim vendimin e qëndrimin e Komisionit për Buxhet se si të veprojmë me rekomandime. Ju faleminderit.